LIGJ
Nr.7641, datë 1.12.1992

PËR MIRATIMIN ME DISA NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.295, DATË 15.9.1992 "PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË MJETEVE MOTORIKE PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PERSONAVE TË TRETË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 20.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të miratojë dekretin nr.295, datë 15.9.1993 "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë" me këto ndryshime:

- Neni 5 i dekretit ndryshohet si vijon:

"Siguruesi e pajis mbajtësin e mjetit motorik, në kohën e lidhjes së kontratës së sigurimit, me modelin "Vërtetimi miqësor i ngjarjes - Njoftimi i rastit të sigurimit", si dhe me shenjë dalluese e cila mban emrin e siguruesit, numrin e targës së regjistrimit të mjetit motorik dhe afatin e vlefshmërisë së kontratës së sigurimit.

Siguruesi e pajis mbajtësin e mjetit motorik, në fund të periudhës së treguar në kontratën e sigurimit, me modelin e "Dëshmisë së rrezikut".

Forma dhe përmbajtja e "Vërtetimit miqësor të ngjarjes Njoftimi i rastit të sigurimit", i "Dëshmisë së rezikut", i shenjës dalluese, mënyra dhe vendi i vendosjes së kësaj të fundit, përcaktohen nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë".

- Pas nenit 9 të dekretit shtohen 2 nene, përkatësisht neni 9/1 dhe neni 9/2, si më poshtë:

Neni 9/1

"Kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë, përveç sa parashikohet nga neni 264 i Kodit Civil, mund të hyjë në fuqi edhe në momentin e lidhjes së kësaj kontrate në rastin kur:

a) mjeti motorik vihet në qarkullim me targë të përkohshme;

b) mjeti motorik është siguruar me një kontratë sigurimi të përkohshme;

c) mjeti motorik është siguruar me një çertefikatë ndërkombëtare të sigurimit (kartoni jeshil);

ç) mjeti motorik me targë regjistrimi të huaj lidh me një sigurues vendas "kontratën e sigurimit kufitar".

Kontrata e sigurimit, në marrëveshje mes palëve, mund të hyjë në fuqi në një moment më të mëvonshëm nga ai i lidhjes së saj".

Neni 9/2

"Kontrata e sigurimit sipas nenit 2 të këtij ligji zgjidhet në qoftë se pas lidhjes së saj pushon së ekzistuari mjeti motorik i siguruar ose ai nuk mund të përdoret më, por siguruesi ka të drejtën mbi pjesën e primit të paguar ose këstet e primit për t'u paguar deri në momentin kur i njoftohet vërtetimi i rasteve të lartpërmendura".

- Neni 10 i dekretit ndryshohet si më poshtë:

"Përgjegjësia e siguruesit nuk mund të jetë më e vogël se vleftat e përcaktuara në listën e vleftave minimale të shumës së siguruar, që është pjesë përbërëse e këtij dekreti.

Vlefta minimale e shumës së siguruar, të përcaktuara sipas grupeve të mjeteve motorike për një aksident, për një person dhe për dëme pasurore, mund të ndryshohen me ligj, në qoftë se kjo është

e nevojshme për të realizuar mbrojtje të mjaftueshme të personave të dëmtuar dhe nëse vërtetohen ndryshime të kushteve ekonomike".

- Neni 16 i dekretit ndryshohet si më poshtë:

"Kushtet e kontratës së sigurimit dhe mënyra e llogaritjes së primit të sigurimit i paraqiten për miratim ministrit të Financave dhe Ekonomisë për një periudhë kohore zbatimi jo më të shkurtër se një vit nga dita e miratimit të tyre, i cili publikon edhe rregullat lidhur me zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike.

Për rreziqet e sigurimit, që për shkak të natyrës së tyre nuk mund të përfshihen në zërat e mënyrës së llogaritjeve të primit të sigurimit, siguruesi mund të përcaktojë vetë primin e sigurimit. Kontrata e lidhur me këtë mënyrë duhet t'i paraqitet ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, i cili jep pëlqimin ose urdhëron ndryshimin e kontratës së sigurimit, të cilat e shtrijnë efektin e tyre që nga dita e hyrjes së saj në fuqi".

- Pas nenit 16 të dekretit të shtohet një nen tjetër, 16/1, me këtë përmbajtje:

Neni 16/1

"Siguruesit që ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personit të tretë, janë të detyruar të hartojnë dhe t'i paraqesin ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, së bashku me bilancin e përgjithshëm të ushtrimorit, një rendikont të posaçëm lidhur me ushtrimin e kësaj veprimtarie sigurimi, si pjesë përbërëse e këtij bilanci.

Nga rendikonti duhet të rezultojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet për këtë lloj sigurimi, gjendja pasurore, si dhe pasqyra analitike e fondeve të caktuara për mbulimin e rezervave teknike".

- Neni 18 i dekretit ndryshohet si më poshtë:

"Nga fondi i kompensimit paguhen:

a) në rastin e përmendur në nenin 17, shkronja "a - vdekja, dëmtimi i shëndetit si dhe dëmet pasurore që e kalojnë vleftën 25 000 lekë, duke përjashtuar dëmin e shkaktuar mjetit motorik;

b) në rastet e përmendura në nenin 17, shkronja "b", "c" dhe "ç" - vdekja, dëmtimi i shëndetit dhe dëmet pasurore, duke përfshirë edhe dëmin e shkaktuar mjetit motorik".

- Neni 21 i dekretit ndryshohet si më poshtë:

"Ministri i Financave dhe i Ekonomisë, me akt të veçantë nënligjor, përcakton mënyrën e financimit të fondit të kompensimit.

- Neni 24 i dekretit ndryshohet si më poshtë:

"Byroja Shqiptare e Sigurimit kryen administrimin e fondit të kompensimit.

Bilanci i administrimit të fondit të kompensimit, së bashku me relacionin përkatës duhet t'i paraqitet ministrit të Financave dhe të Ekonomisë brenda 31 majit të vitit pasardhës".

- Pas nenit 24 të dekretit të shtohen dy nene si më poshtë:

Neni 24/1

"Byroja Shqiptare e Sigurimit i propozon për miratim ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, siguruesit që duhet të emërohen për të kryer trajtimin dhe pagesat e dëmeve të shkaktuara në rastet e parashikuara nga neni 17 i këtij dekreti, duke mbajtur parasysh aftësinë financiare, si dhe cilësinë e organizimit të tyre lidhur me likuidimin e dëmeve.

Siguruesit e përmendur në paragrafin e mësipërm, duhet të administrojnë në mënyrë të pavarur të gjitha operacionet që lidhen me likuidimin e dëmeve të ardhura në rastet e parashikuara nga neni 17 i këtij dekreti".

Neni 24/2

Byroja Shqiptare e Sigurimit për trajtimin e dëmeve të shkaktuara nga një mjet motorik i mbuluar në sigurim nga çertefikata ndërkombëtare e sigurimit (kartoni jeshil), mund të ngarkojë një sigurues që është anëtar i saj.

- Neni 30 i dekretit ndryshohet si më poshtë:

"Personat që nuk kanë dokumentet e treguara në nenin 27 të këtij dekreti, duhet që në kufi të lidhin kontratë sigurimi për përgjegjësinë ndaj personave të tretë, me një sigurues vendas, i cili

autorizohet për ushtrimin e kësaj veprimtarie nga Byroja Shqiptare e Sigurimit".

- Neni 34 i dekretit të ndryshohet si më poshtë:

"Përdorimi ose lejimi i përdorimit të një mjeti motorik nga mbajtësi i tij, pa lidhur një kontratë sigurimi për përgjegjësi ndaj personave të tretë, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 35 000 lekë".

- Neni 41 të kalojë para nenit 40.
- Fjalët "të urdhërave" në rreshtin e dytë të nenit 40 të bëhen "të udhëtarëve".
- Në listën e vleftave minimale të shumës së siguruar të bëhen këto ndryshime:
- Gërma "a" e pikës 1 të bëhet "për një rast sigurimi".
- Gërma "a" e pikës 2 të bëhet "për një rast sigurimi".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më 1.1.1993

Shpallur me dekretin nr.387, datë 9.12.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërsië, Sali Berisha.